

GJOVALIN SHKURTAJ**PROF. DR. JORGJI GJINARI PEDAGOGU, KOLEGU DHE
BASHKAUTORI IM**

Pyetjet dhe përgjigjet lidhur me veprimtarinë dhe ndihmesat e prof. Jorgji Gjinarit mund të ishin të shumta, porse unë, në hapësirat nevojshite të rrudhura të një artikulli, po edhe duke iu përmbajtur karakterit kryesisht jubilar të veprimtarisë kushtuar këtij personaliteti, po ndalem kryesisht në **tri prej tyre**: kur dhe ku e njoha; për sa kohë kam qenë në pranë tij dhe, natyrisht, si kanë qenë për mua ai në të tria raportet e përthekuara në titullin e kësaj ndihmese: si mësimdhënës (pedagog në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë), si koleg zyre (për një periudhë 23 vjet (1967-1990) në punë në të njëjtin sektor studimesh dhe në hartim e gatitje veprash të përbashkëta), si bashkudhëtar në ekspeditat dialektologjike të shumta kryqetërthor Shqipërisë, po edhe në Kosovë e në ngulimet arbëreshe të Kalabrisë; si bashkëpunëtor e si bashkautor e drejtues në disa prej punëve të rëndësishme, si hartimi i Parimeve themelore të *Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe* (ADGjSh-ja) dhe i Pyetësorit të përkatës, në anketimet dhe shkencorizimin e lëndës për *Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe* në dhe për fishat e ALE-së dhe për hartografimin e ADGjSh-së, ku prof. Jorgji ka pasur edhe rolin e përgjegjës në kryesore dhe më takon ta them edhe në emër të të ndjerit prof. dr. Xheladin Gosturani: në qoftë se Ai (i ndjeri) dhe unë, si më të rinjtë e grupit asokohe, kemi bërë më shumë anketime në terren, qoftë edhe në pikat më të largëta si Vermoshi e Konispoli, Tropoja e Mirdita, Mokra e Labëria, prof. Jorgji, ka qenë gjatë tërë kohës si “klluka mbi vezët” mbi hartat e ADGjSh-së dhe ka bërë aty një punë mjeshtërore e shembullore.

Edhe mbas largimit tim nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, me prof. Jorgjin kemi pasur bashkëpunim e bashkautorësi dhe fryt i asaj pune ka qenë edhe teksti ynë i përbashkët i “Dialektologjisë”¹, i cili ka pasur disa ribotime dhe ka vlejtur e do të mbetet edhe më tej si libër themelor e bazë për formimin e studentëve dhe pasuniversitarëve në lëndën homonime. E kemi botuar, së pari, në vitin 1997, si botim të SHBLU-së te Shtypshkronja “Pegi” (457 faqe); është ribotuar në vitin 2000, pa ndryshime, nga Shtypshkronja P.S.H. dhe më 2003 e 2009, gjithmonë si botim i SHBLU-së me disa përmirësime e plotësime të vogla.

¹ Shih: J. Gjinari, Gj. Shkurtaaj, *Dialektologjia*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Shtypshkronja “PEGI”, Tiranë, 1997, f. 557 faqe.

Më duhet të thërras në ndihmë e t'i parafrazoj vargjet e poemës “Kënga e Sprasme e Balës”: “...*Mori bilë, bilë e Lalës, pse më çon në mon' e shkuam?*”.

Ajo që do të them në punimin tim, sado shkurt që t'i bie, fillesën e ka të largët në kohë, sepse njohja dhe, në vijim, bashkëpunimi me prof. Jorgji Gjinarin, kanë nisur në vitin akademik, tashmë të largët, 1964-65, së pari, si student në lëndën e dialektologjisë, ku jubilarin ynë ishte titullar i lëndës dhe njëri nga ata që do të na çelte shtigje e do të na përudhte në lëmin e një discipline jo vetëm interesante, por edhe dorëmbarë e frymëgjatë e që, pikërisht për hir të ideimit, nxitjes dhe dashamirësisë së treguar nga Ai, dialektologjia do të bëhej “kali i betejës” i jetës dhe i veprimtarisë sime.

Në ato vite, vetëm pak kohë mbasi ishte themeluar Universiteti i Tiranës, shumë prej pedagogëve i kishim të rinj në moshë: prof. Anastas Dodi i ndjerë, dhe prof. Jani Thomai që na jepnin Fonetikë e Leksikologji (e cila asohere bëhej si lëndë e përbashkët) ishin diku te të 30-at, kurse Jorgji ishte diçka më i pjekur se ata, por ende pa i mbushur të 40-at. Dyzetyjetorin do t'ia festonim në vitin 1971 në Sektorin tonë të Gramatikës e të Dialektologjisë dhe ka qenë një nga festimet më të bukura të asaj kohe gratçore.

I qartë dhe kthjellët në shpjegimin e lëndës, i qetë dhe me zë të shtruar, por të qartë e me theksimet e nevojshme për shembujt e hollësitë rreth dukurive e tipareve të dialekteve e të folmeve, kërkues në seminarët e në provimin e lëndës, por edhe i drejtë e i peshuar në vlerësimin me notë. I atillë do të mbetej ai edhe gjatë gjithë kohës që, hera e mbarë do ta binte, të kem qenë në shoqërinë e tij në provimet e lëndës, si shoqëruar e në kuadrin e kërkesës së Universitetit për të qenë kurdoherë dy veta në provime: titullari dhe një i dytë. Ia di për nder prof. Jorgjit se urtësia dhe matura e tij në vlerësimin e studentëve, natyrisht edhe gjakftohtësia e tij, do të më mbeteshin si model dhe, me sa kam mundur, i kam zbatuar edhe në vitet kur do të isha unë titullar lëndësh në Fakultet.

Si student, e kam parë prof. Jorgjin edhe në disa prej veprimtarive shkencore që bëheshin në atë kohë në sallën e madhe të Fakultetit e Historisë e të Filologjisë, prej të cilave mbaj mend mbledhjen për të festuar 50-vjetorin e ditëlindjes së prof. Mahir Domit (në mars të viti 1965), si dhe ndonjë nga sesionet shkencore, ku ftoheshin edhe studentë si dëgjues.

Në vitin 1965-1966, me ideimin dhe udhëheqjen e prof. Gjinarit punova për temën e diplomës kushtuar **së folmes së Kastratit**, vendlindjes sime dhe, në një fare mënyre, do të ndiqja shembullin më klasik të dialektologëve, që e fillojnë hulumtimin me të folmen e vendlindjes. Kështu kishte bërë edhe vetë prof. Jorgji me **të folmen e qyteti të Beratit**, prof. Jani Thomai me **të folmen e Semanit** dhe shumë të tjerë. Më vonë, nga leximet e përvojës së dialektologëve të shquar evropianë, do të mësoja se ashtu kishte

vepruar edhe Andre Martineja me të folmen e Hotëvilës (Hauteville), Giovanni Battista Pellegrini me të folmet e Regione Venetos etj.

Gjatë verës së vitit 1965 kam ndërmarrë shtegtime hulumtuese në krah të krahinës së Kastriotit, duke zbatuar me përkushtim e gati me fanatizëm porositë që na kishte dhënë prof. Jorgji në leksionet e dialektologjisë, lidhur me kërkesën e regjistrimit të lëndës vetëm në çastin kur e shqipton subjekti dhe në asnjë mënyrë mbi bazën e kujtesës, qoftë edhe kur je i sigurt se ashtu thuhet fjala. Kjo më ka ndihmuar shumë dhe do të bëhej edhe këshilla ime e vazhdueshme për studentët, porse edhe më ka shkaktuar ndonjë qesëndisje e shpotitje nga bashkëvendësit e mi. Po pyesja njërin nga burrat e vjetër të lagjeve Aliaj për emërtimin e pjesëve të qerres, duke i parë konkretisht të gjitha pjesët në një qerre pranë stallës ku ishin duke shtënë duhan në vargje një skuadër e tërë me gra e burra të lagjes Gjekmuçaj (Bajzë). Kur unë kisha shkruar fjalën **gavelli i qerres** dhe do të vazhdoja të pyesja për pjesët e tjera, një kokë zgjatet nga gardhi i stallës dhe thotë me qesëndi: “*Kush a ky i meçim ç'i nuk e din si i thonë buciels së qierrit?*”. Plasi gazi në stallë dhe unë, sigurisht, i skuqur nga turpi, u detyrova ta kaloja atë situatë me të butë, i zgjata një cigare Lan Idrizit, plakut hokatar që më njihte e më donte, sepse ishte moshatar e mik i tim eti dhe, madje, mbasi i shpjegova se pse më duheshin ato fjalë, e lashë me të që do të shkruaja edhe prej tij disa tregime e fjalë të moçme.

Asokohe Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, si dhe Instituti i Folklorit ishin në godinën e Fakultetit të Historisë e të Filologjisë, sepse ishin ende pjesë e Universitetit. Prof. Jorgji e kishte zyrën në katin e tretë, aty ku sot është një nga zyrat e Departamentit të Historisë: një zyrë e ngushtë dhe ku ishin disa prej gjuhëtarëve që i njihnim ngaqë na kishin dhënë mësim, si prof. Mahir Domi, prof. Selman Riza. Me zellin e djaloshit që sheh me përparësi punën e vet, atë vit, kushedi sa herë shkoja në atë zyrë për të takuar prof. Jorgjin, pa e tjerë gjatë se ai mund të kishte edhe punët e veta, porse ai gjithmonë ishte i gatshëm për konsultime dhe, për të mos i shqetësuar kolegët, ma bënte me shenjë që të prisja jashtë dhe, dikur, edhe unë do ta kuptoja se duhej të shkoja sa më rrallë, po edhe duke zbatuar një grafik pune që të ishte i atillë që të mos shkaktonte ndërprerje pune për atë dhe, sidomos, të mos shqetësoheshin ata që punonin në një zyrë me të.

Në mbarim të studimeve, në qershor të viti 1966 mbrojta diplomën dhe, sikundër dihet, deri atëherë, shumica e studentëve jepnin provime shteti për filozofinë dhe lëndët e degës. Vetëm për pak veta, kryesisht ata që e kishin mesataren e notave shumë të lartë, mund të mbronin një temë diplome dhe të jepnin vetëm provimin e filozofisë. Ajo ditë, kur para komisionit të kryesuar nga prof. Koço Bihiku, në sallën që sot është Instituti i Studimeve Evropiane, në katin e parë, kam përjetuar emocionet e para të “etheve”

shkencore dhe përveç diplomimit me sukses, fati e deshi që të kisha fituar edhe ngrohtësinë e përkrahjen dashamirëse të prof. Jorgji Gjinarit.

Shumë prej studiuesve të rinj, të pranishëm në këtë sallë, që përpos kompjuterit kanë me siguri edhe telefona modernë (i-fonë e androidë), me të cilët mund jo vetëm të shkruajnë e të komunikojnë, po edhe të regjistrojnë tekste e të fotografojnë çfarë të duan, e kanë jo të lehtë ta përfytyrojnë se sa “murg” duhet të ishte një mësues në një fshat të Bregut të Matës, pa dritë elektrike, në një dhomë fjetjeje me katër mësues të tjerë, të cilët meqë ishin nga Lezha ose Shkodra, të shtunave shkonin në shtëpitë e tyre, kurse unë, në pamundësi të shkoja deri në Malësi të Madhe, mbetësia fillikat dhe para një lllambe me vajguri lexoja e shkruaja deri vonë. Por, veprimtaria më jep rastin të kujtoj e të pohoj se në atë periudhë kohe si mësues në Bregun e Matës kam pasur *dy shtylla mbështetëse*, që nuk mund t’i harroja dhe nuk i kam harruar kurrë: dashamirësinë dhe dashurinë e malësorëve të Bregut të Matës, të cilët, meqë edhe unë isha malësor, më shihnin si djalin e tyre dhe, ndonëse nuk mbërrija të shkoja në fundjavë në shtëpinë time, më kanë afruar e më kanë qëndruar gati për të më ndihmuar jo vetëm si subjekte dialektologjike, po edhe me mikpritjen e tyre; *shtylla tjetër*, natyrisht edhe më e fortë e më shpëtimtare ka qenë prof. Jorgji Gjinari, *i cili më ka mbajtur me “gajret”, më udhëzoi të vazhdoja punën e hulumtimit në lëmin e dialektologjisë dhe, së pari, pa humbur kohë, më nxiti ta përpunoja temën e diplomës për ta botuar në revistën “Studime filologjike”*². Po ashtu, me ideimin e tij fillova të mblidhja lëndë dialektologjike për të folmet e Bregut të Matës dhe për të folmet e tjera të Malësisë së Madhe, duke nisur me një punim *për të folmen e Hotit*, të cilën edhe do ta mbaja si kumtesë në Konferencën e Parë të Studimeve Albanologjike, kushtuar 500-vjetorit të vdekjes së Gj. K. Skënderbeut, në janar të vitit 1968.

2. Për figurën, vlerat dhe meritat shkencore të prof. dr. Jorgji Gjinarit nuk besoj se mund të them as më shumë (e as më mirë) se ato që janë shkruar për të nga Enver Hysa në zërin përkatës të *Fjalor enciklopedik shqiptar* (FESH), Tiranë, 2008, f. 842, dhe nga sa u parashtua në referimin e Anila Omarit. Bashkohem plotësisht me ato vlerësime dhe, pa u zgjatur, do të shtoj vetëm disa fjalë për dy nga veprat e mëdha të Jorgji Gjinarit: për monografinë e tij “Dialektet e gjuhës shqipe” (1989, ribotuar më 2014), e cila do të mbetet si paraqitja më e plotë dhe më e mirë e shtrirjes, strukturës dhe ndarjes dialektore të gjuhës shqipe; vepër që përmban fryte e një jete të tërë hulumtuese e pasqyruese të autorit mbi dialektet dhe të folmet e shqipes, shkruar me dije e zotësi dhe me përkushtim të lëndueshëm e të lakmueshëm për të gjithë ata që do të merren me dialektologji.

² Shih: Gj. Shkurtaç, *E folmja e Kastratit*, “Studime filologjike”, 1967, nr. 2 dhe 3.

Do të them edhe pak fjalë për *Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe*, vepër kolektive, e ideuar, e drejtuar dhe e redaktuar nga Jorgji Gjinari. Për të qenë sa më i qartë dhe i kuptueshëm në vlerësimin tim për *Atlasin*, si vepra më madhështore e dialektologjisë shqiptare, por edhe më e keqvlërësuar dhe gjakhupësja, do të mbështetem në një thënie të Dudenit, i cili, sikundër e dinë kolegët e pranishëm, në ballinën e Gramatikës së tij të njohur të gjermanishtes, ka shkruar këtë thënie lapidare në latinisht: “*Due res longue sunt difficilimae: lexicon scribereet grammataicam*” (Dy gjëra përherë janë të vështira: të shkruash fjalor dhe gramatikë).

Dudeni i madh e i mençur ka pasur të drejtë, por ai nuk e ka ditur se çfarë vështirësish ka hartimi i atlaseve gjuhësore; përveç punës në tryezë a në zyrë e në kartotekë, atlasit ka nevojë, më parë, për vajtje afatgjata në terren, në pika të banuara të caktuara, kryesisht në malësi e katunde të largëta, po edhe në qendrat urbane, të gjenden informatorët e përshtatshëm dhe të kryhet anketimi i plotë dhe me akribinë e nevojshme, me alfabetin fonetik ndërkombëtar dhe me shenjat diakritike të nevojshme për tejshkrimin sa më besnik e të saktë. Pastaj, vijon puna jo pak e mundimshme e skedimit të materialeve, të gjitha me dorën e vetë mbledhësit dhe me rrezikun që të bëhet ndonjë lajthitje në tejshkrim e në pasaportizim, ndërsa për çdo tingull a kuptim fjale të dyshimtë, duhen orë e ditë të tëra pune në fonotekë, për t’i ridëgjuar përgjigjet a tekstet përkatëse.

Dhe, për ta bërë këtë më konkrete, po lejohej të kujtoj se për *Atlasin* kemi punuar, ndonjëherë, edhe në kushte gratçore, me mjete komunikacioni të pamira, kryesisht me një kamionçinë “Zuk” të Akademisë, që kishte vetëm një vend përpara disi të rehatshëm, për më të moshuarin e grupit, kurse ne të tjerët, më të rinj, rrinim mbrapa, bashkë me udhëtarë që duhej me doemos t’i merrnim nëpër agjencitë e qyteteve të ndryshme, duke mos guxuar të udhëtonim me vende bosh në makinë, sepse makina ishte shtetërore dhe duhej shfrytëzuar...

Por, pavarësisht nga rrethanat, kemi punuar me kujdesin dhe zellin e asketëve dhe kjo periudhë anketimi, skedimi e përpunimi të lëndës, bashkë me hartografimin ka qenë e gjatë, për njëzet vjet radhazi, duke e përfunduar veprën në vitin 1990. E kemi filluar këtë vepër në moshë të re, ende pa grada e tituj të lartë shkencorë, pastaj, dora-dorës, duke u ngarkuar me shëngjergja, me rrudha e thinja, do të na duhej të prisnim edhe gati njëzet vjet të tjera, derisa vepra, më në fund, të botohej në Itali, për hir të dashamirësisë dhe kujdesit të Universitetit të Napolit l’Orientale dhe të bashkësive arbëreshe të Rexhionit të Kampanies.

Kryetari i grupit tonë, prof. dr. Jorgji Gjinari, po shkon drejt të 85-ave, njëri nga autorët, i ndjeri Xheladin Gosturani, u nda së gjallësh shpejt dhe as që e mbërriti ta shihte të botuar kryeveprën tonë...; po ashtu, nuk janë më

ndër të gjallët as bashkëpunëtorët e kësaj vepre: fonetikani Anastas Dodi dhe dialektologu e sintaksologu i shquar Menella Totoni, por nuk do të zgjatem me këso shënimesh pikëlluese. Kemi kënaqësinë dhe harenë që, sidoqoftë, vepra u botua, në dy vëllime madhore, do të thosha për fat të mirë edhe tipografikisht madhështore. Por, ndërkaq, për atë vepër, për gjurmët e vështira të bëra nga ekipi ynë realizues, vlerësimi zyrtar ka qenë *nga më të këqijtë e mundshëm* ose, për ta thënë më qartë, *ka munguar plotësisht*. Një përrurim gati me zë të ulët në Akademinë e Shkencave, një përrurim në Universitetin e Gjirokastrës dhe ndonjë recension vlerësues nga disa pedagogë të rretheve, si prof. dr. Tefë Topalli e dr. Anisa Kosteri (nga Universiteti i Shkodrës).

I vetmi përrurim serioz dhe i shoqëruar edhe me fjalë miradije e vlerësime shkencore të vyera ka qenë në Universitetin Oriental të Napolit dhe në Bashkinë Arbëreshe të Grecit (Avelino) në vitin 2008, ku kemi marrë pjesë tre autorët që jemi ende gjallë dhe ku janë mbajtur disa kumtesa nga ne autorët, po edhe nga figura të dalluara të profesoriatit italian, si p.sh. nga glotologu i shquar Romano Lazzaroni i Universitetit të Firences, prof. Nullo Minissi i Universitetit të Napolit dhe prof. Italo Costante Fortino, përgjegjës i Katedrës së shqipës në Orientale të Napolit, i cili është edhe figura që realizoi botimin e veprës në Itali.

Asnjë vlerësim, asnjë çmim, as për veprën në tërësi, as për autorët e saj.

Do ta mbyll fjalën time, duke pohuar me bindje (po edhe me keqardhje) se për veprën *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, drejtuesit të saj, prof. dr. Jorgji Gjinari, si dhe grupit të autorëve të kësaj vepre madhore e madhështore e të papërsëritshme (B. Beci, Gj. Shkurtaç, Xh. Gosturani) u duhej dhënë, më së paku “Çmimi i Republikës i Shkallës së Parë”.

SUMMARY

PROF. DR. JORGJI GJINARI, MY TEACHER, COLLEAGUE AND CO-AUTHOR

The author discusses Gjinari's personality in three aspects: Gjinari's contributions in teaching process as lecturer at the Faculty of History and Philology, as an office colleague for a period of 23 years (from 1967 to 1990 we worked in the same fields of study and designed together different projects), as a companion in numerous dialectological expeditions all around Albania, in Kosovo and other Albanian settlements like Calabria; as a collaborator and as a co-worker in some important works, such as the drafting

of the basic Principles of ADGjSh and the corresponding Questionnaire, the drafting of the relevant surveys for the scientific improvement of the materials for the Dialectological Atlas of Albanian Language, the chips of ALE and the mapping of ADGjSh, where Professor Gjinari had the main role and responsibility. We have done many surveys in terrain, even in the most distant geographic points such as Konispol, Vermosh, Tropoje, Mirdita, Mokra and Labëri. Professor Gjinari has always been considered as “a big cheese” in regard to ADGjSh's maps and he made a wonderful job.

There is nothing more I can say in regard to Professor Gjinari's scientific contribution and personality, since they are described in details in the “Albanian Encyclopedic Dictionary” FESH (Tirana, 2008, p. 842) and in the speech hold by Professor Anila Omari. I totally agree with the previous reviews and without further ado, I will only say a few words in regard to two of his greatest works: his monograph “The dialects of Albanian language” (1989, republished in 2014), which represents the most comprehensive and the best presentation of the expansion, structure and separation of the Albanian language dialects. This is a work resulting from a lifetime of research on the dialects of Albanian language which reflects his knowledge, skills and dedication; thus, representing a great example for all those who are engaged in the studying of dialectology.

Professor Jorgji Gjinari has also the merit of being the director and organizer of the work for the creation of the Dialectological Atlas of the Albanian Language, a group work, which was conceived, directed and edited by him. In addition to working beyond the desks, in the office or archives, the creation of the Atlas made it necessary the travelling in terrain, in the most remote inhabited places, mainly in the highlands of remote villages, even in urban centres, in order to find the appropriate informants and to carry out the full survey and to do the complete transcriptions according to the international phonetic alphabet and diacritical marks needed for a loyal and correct transcription. The period of time needed for the survey, filing, processing of the material and its mapping has been very long, nearly twenty years. The work was completed in 1990. However, we are pleased that the work was published in two major volumes and I would say with a magnificent typography. Unfortunately, the official assessment done for this work and for the difficulties faced by our team has been the worst possible, or, to put it more clearly, is completely missing. We can mention here the almost ‘silent’ inaugurations done at the Academy of Sciences, at the University of Gjirokastra and some reviews written by several professors.

The only serious inauguration which highlights the scientific values of the work is the inauguration organized by the Oriental University in Naples and the Arbëresh Municipality of Greci (Avelino) in 2008. At these event

three of the authors who are still alive participated and held some papers together with some outstanding Italian professors, such as the prominent glottolog Romano LAZZARONI of the Florence University, professor Nullo Minissi of the University of Naples and professor Italo Costante Fortino, head of the Department of Albanian language in Orientale University of Naples, who is the person that realized the publication of the work in the Italian language.

Finally, I will conclude very briefly by asserting confidently (but with great regret) that Professor Gjinari, and the group of authors (B. Beci, Gj. Shkurtaç, Xh. Gosturani) who made possible this magnificent and unrepeatable work “Dialectological Atlas of the Albanian Language” should have received a better recognition, at least the prize “Çmimi i Republikës i Shkallës së Parë.”